



Fëmijët e moshës shkollore të porsaardhur

Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të moshës shkollore që sapo kanë ardhur në një komunë të Cyrihut, kanë të drejtë dhe janë të detyruar, ta frekuentojnë shkollën. Kjo vlen që nga fillimi i banimit dhe pavarësisht statusit të leje qëndrimit të fëmijës. Në shkollën e detyrueshme bën pjese edhe kopshti për fëmijë.

Detyrimi shkollorë

Detyrimi shkollorë zgjat njëmbëdhjetë vjet, më së shumti deri në mbarimin e shkollës fillore. Ai mund të plotësohet edhe në shkollat e lejuara private.

Fëmijët që kanë mbushur moshën 4 vjeçare¹, në fillim të vitit tjetër shkollorë hynë në moshën shkollore dhe kështu ata duhet ta frekuentojnë kopshtin për fëmijë. Në shkollat fillore shtetërore nuk është e mundur zgjedhja e shkollës sipas dëshirës: Fëmijët frekuentojnë shkollën aty ku ata banojnë. Autoritetet lokale shkollore (komisioni shkollorë) i ndajnë fëmijët nëpër shkolla.

Prindërit janë të lirë për të zgjedhur një shkollë private.

Regjistrimi i fëmijëve

Nëse një fëmijë zhvendoset në një komunë të Cyrihut, prindërit e tij duhet ta regjistrojnë atë menjëherë tek autoritetet lokale shkollore (komisioni shkollorë). Ky detyrim vlen për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e moshës shkollore. Sapo të fillojë të banojë familja në kantonin e Cyrihut, me rëndësi është që prindërit ta kontaktojnë mundësisht menjëherë komisionin shkollorë (Schulpflege), për të diskutuar mbi regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe për ti sqaruar pyetjet. Adresat e autoriteteve lokale shkollore mund ti gjeni në faqen e internetit të komunës dhe në atë të shkollës. www.vsa.zh.ch/schulen

1 Dita e caktuar e fillimit të shkollës

<i>Viti shkollorë</i>	<i>Zyrtarisht më:</i>
2013/14	30 prill
2014/15	15 maj
2015/16	31 maj
2016/17	15 qershor
2017/18	30 qershor
2018/19	15 korrik
Nga viti 2019/20	31 korrik



Hyrja në shkollë

Komisioni shkollorë i cakton fëmijët nëpër shkolla. Drejtoria shkollore është përgjegjëse për ndarjen e duhur nëpër klasa. Klasa duhet ti përshtatet mundësisht moshës së fëmijës. Nëse fëmija flet pak gjermanisht ose nuk e flet fare atë - atëherë ai frekuenton veç mësimin të rregullt – mësimin në “gjermanishten si gjuhë të dytë” (DaZ). Mësuesi i klasës së rregullt mbështet fëmijën për tu integruar dhe për ta përpunuar lëndën mësimore të klasës.

Në qytete ka pjesërisht „klasa pranuese “. Në këta klasa fëmijët qëndrojnë sipas rregullit maksimalisht një vit. Ata aty mësojnë gjuhën gjermane dhe përgatiten për daljen në një klasë të rregullt.

Për të rinjtë e emigrantëve të moshës 15 deri 21 vjeç, shkolla për zgjedhjen e profesionit ofron “një vit përgatitor special të profesionit, gjuha dhe integrimi” Në këtë kurs njëvjetor, para së gjithash të rinjtë mësojnë gjermanishten. Veç kësaj ata gjithashtu fitojnë njohuri që u nevojiten për të hyrë në një shkollë që çon më tej ose për të bërë një shkollim profesional.

www.mba.zh.ch -> [Berufsvorbereitungsjahre](#)

Informacione të mëtejshme për prindërit

Një DVD në 11 gjuhë i informon prindërit hollësisht për shkollën në kantonin e Cyrihut” („Die Schule im Kanton Zürich“).

www.vsa.zh.ch -> [DVD Volksschule](#)

Informacione të mëtejshme – në gjuhët e tjera dhe atë gjermane – mund të shkarkohen nga faqja e internetit të autoriteteve të shkollës filllore.

www.vsa.zh.ch -> [international](#)